



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile, Rehabilitimit, Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbiqyrjes Financiare, I Ekonomisë Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural.

Raport vendimmarrjeje

Nr 12 /Datë 28.01 2026

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin

“PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE ZNJ. XHEMILE SELKO, FAMILJE QË KA PËSUAR DËME SI PASOJË E RENIES SE ZJARRIT NE BANESE” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet perkatëse.

Analiza ligjore:

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 30 gërma “gj”, të Ligjit nr. 45, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen civile”, Kreut III, pika 1, shkronja “ë”, të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

Situata aktuale e funksionit:

Miratimi për akordimin e ndihmës financiare për znj. Xhemile Selko, shumë prej 375 607.37 Lekë (treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatë) Lekë, familje që ka pësuar dëme në orëndi/pajisje elektroshtëpiake dhe të anës ndërtimore si pasojë e rënies së zjarrit në banesën e saj.

Situata financiare:

Sipas dokumentacionit/relacionit që shoqëron projekt vendimin

Drejtoria/Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve

Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar,

Monitorimi dhe raportimi:

Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet që preken:

Qytetare të bashkisë Pogradec

A është objekt i konsultimit publik? Jo

Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile, Rehabilitimit, Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit, Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikëqyrjes Financiare, I Ekonomisë Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural, i mbledhur më datë 28.01. 2026, shqyrtoi projektvendimin “PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE ZNJ. XHEMILE SELKO, FAMILJE QË KA PËSUAR DËME SI PASOJË E RENIES SE ZJARRIT NE BANESE” Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T’i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- (Miratimin e projektaktit.
- b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit.
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Idhise Hekalari; Selma Haxhillari Kryetar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Memoza Shuli; Majeta Bëba Sekretar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë: 28.01. 2026